



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 shtator 2019
Nr. ref.:RK 1427/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

né

rastin nr. KI205/18

Parashtrues

Elmi Dragusha

Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 197/18, të 1 tetorit 2018 dhe Pml. nr. 261/2018, të 16 tetorit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Görxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhami Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Elmi Dragusha (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në fshatin Prugoc, komuna e Prishtinës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kérkesës konteston kushtetutshmërinë e aktvendimeve të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 197/18, të 1 tetorit 2018 dhe Pml. nr. 261/2018, të 16 tetorit 2018 (në tekstin e mëtejmë: Aktvendimet e kontestuara).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kérkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kérkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kérkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksiioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kérkesës] dhe 47 [Kérkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kérkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 28 dhjetor 2018, parashtruesi e dorëzoi kérkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
6. Më 8 janar 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtyues të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdju (kryesues), Remziye Istrefi-Peci (anëtar) dhe Nexhami Rexhepi (anëtar).
7. Më 17 janar 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kérkesës dhe kérkoi nga i njëjti të nënshkruante formën e kérkesës. Një kopje e kérkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
8. Më 23 janar 2019, parashtruesi i kérkesës e dorëzoi në Gjykatë formularin e kérkesës të nënshkruar.
9. Më 5 shtator 2019, Kolegji shqyrtyues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit rapportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kérkesës.

Përbledhja e fakteve

10. Më 27 shkurt 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykin P. nr. 294/2017, parashtruesin e kérkesës e shpalli fajtor për kryerjen e veprës penale nga nen 320, paragrafi 2 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe e dënoi atë me dënim me kusht në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, nëse i njëjti brenda kohës sa ishte i dënuar nuk do të kryente vepër tjetër penale, si dhe

dënim me gjobë në shumë prej 200 €, të cilën duhej ta paguante brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

11. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P. nr. 294/2017, të 27 shkurtit 2017, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
12. Më 9 janar 2018, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin PA1. nr. 483/2017, e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, P. nr. 294/2017, të 27 shkurtit 2017.
13. Më 23 shkurt 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për rishikimin e procedurës penale në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P. nr. 294/2015, të 27 shkurtit 2017 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PA1. nr. 483/20, të 9 janarit 2018.
14. Më 13 prill 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin KP. nr. 365/2018, e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishikimin e procedurës penale, me arsyetimin se kërkesa nuk i plotësonte kushtet ligjore për rishikim për shkak se nuk kishte fakte dhe prova të reja, sipas të cilave do të lejohej rishikimi.
15. Kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, KP. nr. 365/2018, të 13 prillit 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së të drejtës materiale.
16. Më 12 qershor 2018, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin PN. nr. 5217/18, e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, KP. nr. 365/2018, të 13 prillit 2018.
17. Më 1 gusht 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P. nr. 294/15, të 27 shkurtit 2017 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PA1. nr. 483/18, të 9 janarit 2018.
18. Kërkesë për mbrojte të ligjshmërisë, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar edhe kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, KP. nr. 365/2018, të 13 prillit 2018 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, PN. nr. 5217/18 të 12 qershorit 2018, me të cilët ishte refuzuar kërkesa e tij për rishikimin e procedurës penale.
19. Më 1 tetor 2018, Gjykata Supreme, me Aktvendimin Pml. nr. 197/18, hodhi poshtë si të paafatshme kërkesën për mbrojte të ligjshmërisë, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P. nr. 294/15 të 27 shkurtit 2017, me të cilin ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar në kohëzgjatje prej 1 (një) viti burgim me kusht dhe me gjobë në shumë prej 200 €, dhe

Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PA1. nr. 483/2017 të 9 janarit 2018, me të cilin ka mbetur në fuqi Aktgjykimi i shkallës së parë.

20. Më 16 tetor 2018, Gjykata Supreme, me Aktvendimin Pml. nr. 261/2018, refuzoi gjithashtu si të pabazuar edhe kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë, ushtruar kundër aktvendimeve të instancave më të ulëta, të cilat refuzuan kërkesën e tij për rishikimin e procedurës penale.
21. Për më tepër, Gjykata Supreme refuzimin e kërkesës së parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë e arsyetoi: *“Në këtë çështje penalo-juridike, dispozitivi i aktvendimit të kundërshtuar është i qartë, konkret, i njëjtë nuk përmban kundërthënie me vetveten e as me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e aktvendimit të shkallës së parë janë dhënë mjaft arsyet për refuzimin e kërkesës e të cilat arsyet i ka aprovuar edhe Gjykata e Apelit, ashtu që provat e ofruara nga i dënuari kanë qenë edhe më parë objekt shqyrthimi gjatë procedurës së mëhershme e të cilat janë vlerësuar, andaj sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në kërkesën e parashtruar nga i dënuari për rishikimin e procedurës penale, nuk është prezantuar ndonjë fakt apo provë e re, e cila ka qenë e panjohur për gjykatën në momentin e marrjes së aktgjykimeve të lartpërmendura, e cila vet apo së bashku me provat e tjera të mëparshme do ta arsyeton pafajësinë e të dënuarit, në këtë mënyrë provat e propozuara nuk mund të paraqiten si arsyet për rishikimin e procedurës në kuptim të nenit 423 par. 1 dhe 2 të KPK”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, si rezultat i shkeljes së të drejtës materiale, ngritjes së aktakuzës dhe dënimit kundër tij pa fakte dhe prova të mjaftueshme, dhe paragjykimit të rastit nga gjyqtarja e gjykatës së shkallës së parë.
23. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon prishjen e të gjitha aktvendimeve të gjykatave të rregullta dhe shpalljen e tij të pafajshëm ose rigjykimin e çështjes.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata së pari shqyrtion nëse parashtruesi i kërkesës i ka përbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrënë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

[...J”.

26. Gjkata po ashtu i referohet neneve: 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kérkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

[...]

“2. Individ mund ta ngritë kérkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kérkesës]

“Parashtruesi i kérkesës ka për detyrë që në kérkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... ”.

27. Për sa i përket përbushjes së këtyre kritereve, Gjkata konstaton se parashtruesi i kérkesës është palë e autorizuar; ka shterur mjetet juridike në dispozicion; ka specifikuar aktin e autoritetit publik të cilin e konteston në Gjykatë dhe të drejtat kushtetuese që pretendon se i janë cenuar, si dhe ka dorëzuar kérkesën në kohë.
28. Megjithatë, Gjkata gjithashtu merr parasysh edhe kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullore të punës dhe për rastin konkret i referohet rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë], nënrrregullit (2) dhe (3) (b) të Rregullore, që përcaktojnë:

“(2) Gjkata mund ta konsiderojë kérkesën të papranueshme, nëse kérkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

“(3) Gjkata mund ta konsiderojë një kérkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:

[...]

(b) kérkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;
[...J”.

29. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta, shkelën të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, e cila, sipas tij, ka ardhur si rezultat i shkeljes së të drejtës materiale, ngritjes së aktakuzës kundër tij pa fakte dhe prova të mjaftueshme, dhe paragjykimit të rastit të tij nga gjyqtarja e Gjykatës Themelore.
30. Fillimisht, Gjykata vëren se kemi të bëjmë me dy lloje procedurash gjyqësore, atë të rregullt (gjykimi për fajësinë), me të cilën parashtruesi i kërkesës u shpall fajtor për kryerjen e veprës penale në kundërshtim me nenin 320 të KPRK-së, dhe kërkesën për rishikimin e procedurës penale, ushtruar kundër aktgjykimeve me të cilat ai u shpall fajtor dhe u dënuar.

Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me procedurën e rregullt penale

31. Në lidhje me këtë procedurë, Gjykata vëren se vendimi i fundit sipas mjetit të fundit juridik të cilin e ka ushtruar parashtruesi i kërkesës është Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Pml. nr. 197/18, i 1 tetorit 2018, me të cilin ishte hedhur poshtë, si e paafatshme kërkesa e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, e cila ishte ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P. nr. 294/15 të 27 shkurtit 2017 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PA1. nr. 483/18, të 9 janarit 2018.
32. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata Supreme, hedhjen poshtë si të paafatshme të kërkesës së parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë, e arsyetozi, si në vijim: “*Nga shkresat e lëndës dhe fletëkthesa për pranimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1. nr. 483/17, të dt. 09.01.2018, del se fletë kthesa është nënshkruar nga ana e të pandehurit me datën 24.01.2018, ndërsa kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë i dënuari e ka paraqitur me dt. 01.08.2018, e cila figuron në vulën e pranimit të kërkesës në gjykatën e shkallës së parë. Andaj, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është paraqitur pas skadimit të afatit 3 (tre) mujor, ashtu siç kërcohët me dispozitën e lartpërmendur ligjore*”.
33. Në këtë kontekst, Gjykata rithekson se është domen i gjykatave të rregullta t'i administrojnë faktet dhe provat relevante të ngritura para tyre, ashtu siç ka vepruar në rastin konkret Gjykata Supreme, e cila vlerësoi vetëm aspektet procedurale të kërkesës së parashtruesit, duke arritur në përfundim se parashtruesi i kërkesës e kishte humbur afatin për të kontestuar në përbajtje aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, me të cilat u shpall fajtor dhe u dënuar.
34. Gjykata, rikujton se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përvëç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të

Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafi 28).

35. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet e tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih, *mutatis mutandis* Gjykata Kushtetuese, rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
36. Gjykata, vëren se parashtruesi i kërkesës thjesht nuk pajtohet me rezultatin e procedurës. Megjithatë, pakënaqësia e tij me rezultatin e pranuar me vendimet e gjykatave të rregullta nuk mund vetveti të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat* kundër *Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21.; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
37. Në bazë të asaj që u tha më sipër, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm janë qartazi të pabazuara, sepse në asnjë mënyrë Gjykata nuk mund të konstatojë se Aktvendimi i Gjykatës Supreme, me të cilën ishte hedhur poshtë kërkesa e tij për shkaqe procedurale shkelë në ndonjë mënyrë të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.

Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me kërkesën për rishikimin e procedurës penale

38. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se vendimi i fundit sipas mjetit të fundit juridik të cilin e ka ushtruar parashtruesi i kërkesës është Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Pml. nr. 261/2018, i 16 tetorit 2018, me të cilin u refuzua kërkesa e tij për mbrojtje të ligishmërisë, e ushtruar kundër aktvendimeve të gjykatave të instancës më të ulët, të cilat vendosën në lidhje me kërkesën e tij për rishikimin e procedurës penale.
39. Në lidhje me këtë, Gjykata fillimisht vë në dukje se, kërkesa e parashtruesit të kërkesës për rishikimin e procedurës penale, nga gjykatat e rregullta u refuzua si e pabazuar nga shkaku se e njëjta nuk i plotëson kriteret procedurale të parapara me ligj, sepse parashtruesi nuk kishte ofruar fakte dhe prova të reja me të cilat do të vihej në pikëpyetje ligishmëria dhe kushtetutshmëria e aktgjykimeve në lidhje me procedurën e rregullt penale.
40. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se pajtueshmëria *ratione materiae* e një kërkesë me Kushtetutë rrjedh nga juridiksioni material i Gjykatës. E drejta në të cilën thirret parashtruesi i kërkesës duhet të mbrohen me Kushtetutë, në mënyrë që ankesa kushtetuese të jetë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën dhe, rrjedhimisht, brenda juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese (shih, Gjykata Kushtetuese, rastin KI07/17, parashtrues *Pashk Mirashi*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 29 majit 2017 paragrin 66).

41. Në vazhdim, Gjykata rikujton praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e miëtejmë: GJEDNJ) dhe praktikën e saj, ku thuhet se neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës dhe neni 6, paragrafi 1 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] i Konventës, nuk zbatohen tek kërkesat për rishikim, apo përsëritje të procedurës (shih, në mënyrë analoge, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI159/15, me parashtrues *Sabri Ferati*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 13 qershorit 2016; KI80/15, 81/15 dhe 82/15, me parashtrues *Rrahim Hoxha*, Aktvendimi për papranueshmeri, i 27 dhjetorit 2016; shih, *inter alia*, *Zawadzki kundër Polonisë*, aplikimi nr. 34158/96, i 6 korrikut 1999; *Sablon kundër Belgjikës*, kërkesa nr. 36445/97, i 10 prillit dhe *Steck-Risch dhe të tjerët kundër Lihenshtajnit* (dec), nr. 29061/08, 11 maj 2010 ... *Nistler kundër Austrisë*, nr. 24912/08, GJEDNJ, Vendim i 19 nëntorit 2013; *Dichev kundër Bullgarisë*, nr. 1355/04, GJEDNJ, Aktgjykim i 27 janarit 2011).
42. Në lidhje me këtë rast konkret, Gjykata specifikisht i referohet rastit të GJEDNJ-së *Franz Fischer kundër Austrisë*, anksa nr. 27569/02, Vendimi i 6 majit 2003, ku u konstatua se neni 6 i Konventës nuk zbatohet në procedurat për rishikimin e ndonjë rasti, përkatesisht kur një person dënim i të cilit është bërë i plotfuqishëm, bën kërkesë për rishikimin e rastit të tij dhe gjatë kësaj procedure nuk është “akuzuar për vepër penale”.
43. Andaj, Gjykata ripërsëritë qëndrimin e saj se në të gjitha rastet kur kërkesa për rishikimin e procedurës penale refuzohet, si e pabazuar ose hedhet poshtë për shkaqe procedurale, nga të gjitha instancat e rregullta gjyqësore, neni 31 i Kushtetutës, në dritën e interpretimit të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nuk është i zbatueshëm.
44. Në këtë sfond, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit në lidhje me refuzimin nga gjykatat e rregullta të kërkesës së tij për rishikim të procedurës penale nuk janë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.
45. Si përbledhje, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës në lidhje me vlerësimin e kushtetutshmërisë së procedurave të rregullta duhet të deklarohet e papranueshme, si qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, si dhe kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë në lidhje me kërkesën për rishikimin e procedurës penale, duhet të deklarohet gjithashtu e papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (3) (b) të Rregullore të punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2), (3) (b) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 5 shtator 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari rapportues

Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

